

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGETARE
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“IARC-USC” SH.P.K.

NENI 1
FORMIMI

Sot ne datë 22.10.2021, themelohet në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“IARC-USC” SH.P.K.** Kjo shoqëri krijohet nga:

Z. FRANCESCO FAVIA, i biri i Nicola, i datëlindjes 24.10.1963, lindur në Bari, Itali dhe banues në Rr. “Napoli” 234/D 70127 Bari, i identifikuar nëpërmjet Pasaportës me Nr. YA5482146, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

NENI 2
SELIA

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **“IARC-USC” SH.P.K.** do te jete në adresën: **Rruga "RIZA CEROVA" Nd.18 Xhajs, H.5, 1017 TIRANE.**

Ortakët mund të vendosin për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“IARC-USC” SH.P.K.** është për një periudhë pa afat.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **“IARC-USC” SH.P.K.** do të jetë:



- **Aktivitete të specializuara skicimi.** Krijimin e Dizenjove Industriale, per tregun vendas dhe te huaj. Krijimin e Brandeve te reja. Promovimin, regjistrimin dhe mbrojtjen e tyre, sipas ligjeve ne fuqi.
- Shtepi botuese, Ideimin, dizenjimin grafik, formulimin e permbajtjes, faqosjen, dhe berjen gati per shtyp, te botimeve te ndryshme ne fushen akademike, letersise, artit, shkences, modes, informacionit, argetimit, femijeve, sportit, etj. IARC-USC, mund te lidhe kontrata me te trete per shtypjen, printimin, shitjen, ose shperndarjen falas te ketyre botimeve.
- Organizim eventesh si, Konferenca Trajnime, dhe Workshop-e, sondazhe ne te gjitha fushat.
- Shërbimin e ndërmjetësimit në punësim. Informim për vendet e lira të punës. Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion. Informacion dhe këshillim. Udhëzime për punësim, vlerësim të nevojave, zhvillim të karrierës apo të profesionit metodika për punësim. Pjesëmarrje në përmirësimin e tregut të punës nëpërmjet trajnimit dhe ndërhyrjeve në përmirësimin e legjislacionit të tregut të punës. Shërbime ndërmjetësimi në të dy kahet për punëdhënësin por edhe për punëmarrësin. Shërbime për punëdhënësit, kryesisht informacion mbi tregun e punës, të ofrimit të kandidatëve të mundshëm për rekrutim në punë, informacion për programet e ndryshme të tregut të punës etj. Shëbrimet e migracionit në fushën e imigrimit edhe atë të emigrimit. Nën këtë përcaktim për “Imigrim”, ofrojmë këshillim ligjor dhe ndërmjetësim në punësim në kuadër të përcaktimeve të ligjit nr. 108/2013; datë 28.03.2013 “Për të Huajt”, i cili rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve nga Republika e Shqipërisë. Referuar vetë subjekteve të mirëpërcaktuara në këtë ligj janë identifikuar të gjithë shtetasit e huaj që synojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë si qëllim tranzitimin, punësimin, studimin apo ripranimin. Këta të huaj trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- Shërbime ne fushen e Marketingut, Marredhenie me Publikun (PR). Shërbime ne fushen e Media Planing, Produksioneve Televizive si edhe Produksioneve Marketingu, krijimin, konceptimin realizimin, promovimin, prodhimin, printimin dhe shitjen e materialeve promocionale, ne median e shkruar, vizive dhe elektronike. Reklama online, offline, Logo, Spote publicitare, krijim dhe mirembajtje te faqeve te internetit, rrjete informatike, aplikacione te ndryshme. Fushata mediatike sensibilizimi si edhe cdo gje tjeter e lidhur me fushen e Marredhenies me Publikun (PR) dhe Marketingut.
- **IARC-USC**, mund te hape dege te saj ne te gjithë boten. Shoqeria ne ushrimin e aktivitetit te saj mund te lidhe marredhenie nenkontraktuale me persona te trete. Do te aplikojë per marrjen e licencave te ndryshme, autorizimeve dhe lejeve te nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, duke u mbeshtetur ne rregullat dhe legjislacionin ne fuqi te Republikës se Shqiperise dhe te vendit ku do te operoje.
- Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, Shoqëria mund të ushtroje veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund të zotërojë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri dhe/ose sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose që mund të ndihmojnë në realizimin e

- objektit të Shoqërisë;
- Të themelojë degë, zyra përfaqësimi dhe në pergjithësi të kryejë çdo aktivitet tjetër që nuk është i ndaluar nga ligji.

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë “**IARC-USC**” **SH.P.K.** është 100.000 (njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre, si më poshtë:

Ortaku **Z. FRANCESCO FAVIA** zotëron 1 (një) kuote të barazvlefshme me 100% të kapitalit themeltar, ekuivalente në 100.000 LEK.

Ky kapital është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kuota e Ortakëve regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese të shoqërisë “**IARC-USC**” **SH.P.K.** janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administratori i shoqërisë, është **Z. SKERDI SULOVARI**.

NENI 7

Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj shprehen në statut i cili së bashku me aktin e themelimit përbëjnë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

NENI 8

Veprimtarinë e saj shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, si dhe në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 9

Të gjitha mosmarrveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore, zgjidhen me mirëkuptim me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar




dhe kur këto mjete nuk japin rezultat, atëhere zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “IARC-USC” SH.P.K. në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë. Në këtë ditë shoqëria “IARC-USC” SH.P.K. njihet si person juridik.

**ORTAKU I SHOQËRISË
“IARC-USC” SH.P.K.**

FRANCESCO FAVIA

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Francesco Favia', is written over a horizontal line. The signature is stylized and somewhat illegible due to the cursive nature of the handwriting.